



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NJOFTIM PËR LIKUIDIM
të
NSH TP “Zhupa” – Recan, Prizren

Emrat alternativë/emrat e mëparshëm dhe numrat e regjistrimit:

Trgovinsko Preduzeće za promet robe na veliko i malo “Sredačka Župa” sa p.o. u Sredsku on 1989
(Fi.384/89)
Deoninarsko Drustvo “Sredačka Župa” u Sredsku on 1995 (Fi.2096/95)

Në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-067 Mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Neni 39.3 dhe 39.6 i Rregullores së UNMIK-ut 2001/6 mbi Organizatat Tregtare, dhe Neni 43.3 (d) dhe (e) dhe Neni 49 i Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve dhe Pasurisë së tyre, **JEPET NJOFTIMI se Likuidimi i Ndërmarrjes së lartpërmendur ka filluar prej 31 Dhjetor 2010**, në bazë të vendimit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit më **19 Nëntor 2010** sipas Nenit 9.1 të Ligjit Nr. 03/L-067.

Në përputhje me nenin 43.3 (d) dhe (e) të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48, çdo person i cili beson se ai/ajo ka të drejtë kërkesë ndaj kësaj Ndërmarrjeje – qoftë si kreditor apo në lidhje me çfarëdo lloj asetit që ka të bëjë me Ndërmarrjen, apo si pronar i Ndërmarrjes, si dhe çfarëdo kërkesë tjetër – **duhet të paraqesë Dëshminë e Kërkesës për Likuidim deri më ose para 20 mars 2011**. Nëse nuk bëhet kjo, mund të rezultojë që personat e tillë nuk do të kenë mundësi të marrin pjesë në ndarjen e fondeve të krijuara nga likuidimi.

Dëshmia e Kërkesës për Likuidim mund të merret dhe duhet të dorëzohet në zyrën e AKP-së si më poshtë:

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rruga: “Pushkatarët” Nr. 9, 20000 Prizren
Kosovë / Kosovo
Telefoni: +381 29 226 480

Formularët për kërkesa gjithashtu mund të merren edhe nga faqja e internetit e AKP-së në adresën www.pak-ks.org. Për detaje se si të dorëzohet kërkesa, shih “Si të paraqitni një kërkesë.”

Lista e aseteve dhe lista e paraqitësve të kërkesave do të mbahet në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në Rrugën: “Pushkatarët” Nr. 9, 20000 Prizren dhe do të jetë e hapur për shqyrtim publik në këtë zyrë pas **20 marsit 2011** (ose ndonjë datë tjetër që mund të shpallet publikisht) deri në njoftimin e ardhshëm. Nëse keni arsye të pranueshme për pamundësinë e udhëtimit deri në vendin e lartpërmendur, ju lutemi të kontaktoni në adresën e mësipërme për të aranzhuar mënyra tjera të qasjes.

Asetet do të ofrohet për shitje nëpërmes tenderit me oferta të mbyllura në datën (jo me herët se **01 shkurt 2011**) që do të publikohet, duke përfshirë edhe në faqen e internetit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (www.pak-ks.org).